



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1689 Prot.
12

Tiranë, më 22.07.2021

V E N D I M

NR. 2

**“PËR SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE PËR KANDIDATËT NGA TRUPA
E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS
SË MAGJISTRATURËS PËR ANËTARËT E KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR DHE KESHILLIT TË LARTE TË PROKURORISË”**

Në mbështetje të neneve 37 dhe 135, të ligjit nr. 115/2016, datë 03.11.2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të neneve 11 dhe 16, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”:

V E N D O S A :

1. Të shpallë dy vende vakante për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe dy vende vakante për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të shkollës së magjistraturës.
2. Shpallja e vendeve vakante dhe kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët sipas nenit 36 të ligjit nr. 115/2016, datë 03.11.2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe nenit 135 të ligjit nr. 115/2016, datë 03.11.2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, të publi kohen në faqen zyrtare të Kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ

